


Asociacioni  
i Komunave  
të Kosovës



# PROGRAMI I PRAKTIKAVE TË MIRA KOMUNALE

Këshilli i  
Evropës



# PROGRAMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA KOMUNALE

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Përgatitur nga: **Arsim Osmani**

Rr. "Gustav Mayer" Nr.5  
Prishtinë

Tel. 038 245 734  
Fax. 038 245 732  
info@komunat-ks.net  
www.komunat-ks.net



Kjo broshurë është pjesë e Programit të praktikave më të mira komunale dhe i cili u mbështet nga Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht edhe qëndrimin e Këshillit të Evropës.

---

Prishtinë, shtator 2012

## ÇFARË ËSHTË PROGRAMI I PRAKTIKËS MË TË MIRË?

Programi i praktikave më të mira të vetëqeverisjes lokale është iniciuara në bashkëpunim nga Këshilli i Evropës dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtij programi është të përzgjedh, të shpërblejë publikisht dhe transferoj praktikat më të mira në mesin e komunave të Kosovës.

Programi ofron identifikimin e komunave që kanë praktikat më të mira në fushat kryesore të përgjegjësisë së tyre. Këtyre komunave do të ju jepet mbështetje në mënyrë që të zhvillojnë kapacitetin e tyre për të ndarë praktikat e tyre më të mira me të tjerët. Komunitet të cilat besojnë se kanë zhvilluar praktikën më të mirë në një nga fushat e caktuara mund të aplikojnë për statusin e praktikës më të mirë.

Nëpërmjet procesit konkurrues, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), Komiteti Drejtues dhe Paneli Përzgjedhës, do të ndërmarrë procesin e përzgjedhjes ose të shpërblej me statusin e Praktikës më të mirë komunitet fituese. Në fushat tematike, të përcaktuara, do të identifikohet një fitues. Me marrjen e statusit të praktikës më të mirë, Komunitet do të nënshkruajë një marrëveshje me Asociacionin e Komunave të Kosovës që të shpërndaj praktikën më të mirë, risitë dhe mësimet e nxjerra në komunitet tjera.

## OBJEKTIVAT

- Rritja e standardeve të pushtetit lokal në identifikimin dhe njohjen e praktikave të reja dhe më të mira në ofrimin e shërbimeve nga administratat lokale;
- Promovoj risitë në fusha të ndryshme nga kompetenca e vetëqeverisjes lokale;
- Promovoj, me institucionet e autoriteteve qendrore, nevojën për inkurajimin dhe mbështetjen e praktikave më të mira të menaxhimit të qeverisjes lokale;
- Të njohim dhe të shpërblejmë praktikën më të mirë në ofrimin e shërbimit nga administratat lokale në fushat kryesore të punës.
- Të kontribuojë në krijimin e një shoqërie të fuqishme civile, duke promovuar një administratë lokale të fortë, të aftë dhe të përgjegjshme.

## KUSH ËSHTË I PËRFSHIRË NË PROGRAM ?

Përveç Këshillit të Evropës (CoE) dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), pjesë e këtij programi është edhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) si anëtar të Komitetit Drejtues të Projektit dhe Panelit Përzgjedhës (më përfaqësim të pakicave dhe anës gjinore) i krijuar për nevojën e realizimit të një programi të suksesshëm.

**Komiteti Drejtues** - Roli i Komitetit Drejtues është që të monitorojë dhe vlerësojë suksesin e zbatimit të “Programit të praktikës më të mirë”, si dhe të monitoroj procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së shembujve të praktikave më të mira.

Komiteti Drejtues është formuar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Këshillit të Evropës, Asociacionit të Komunave të Kosovës, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

**Paneli përzgjedhës** - ka një rol qendror në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e praktikave më të mira në zonat e zgjedhura, ai bën listën e ngushtë të kandidatëve, viziton komunat që janë në listën e ngushtë dhe merr vendimin përfundimtar mbi praktikatat më të mira. Paneli përzgjedhës përbëhet nga përfaqësuesit e Kolegjiumeve Profesionale të AKK-së dhe Menaxheri i Projektit në cilësinë e Konsulentit Lokal.

## FUSHAT TEMATIKE

Aplikimet për statusin e praktikës më të mirë mund të paraqiten në tri fusha tematike:

- 1. Përmirësimi i Shërbimeve Publike Komunale**
- 2. Lehtësimi i procedurave administrative**
- 3. Rritja e të hyrave komunale**

### **1. Përmirësimi i Shërbimeve Publike Komunale**

Shërbimet Publike Komunale janë ‘shtylla’ e shërbimeve që ofron pushteti lokal për qytetarët e vetë. Mënyrat e ofrimi dhe mirëmbajtjes së tyre, reflekton edhe një nga parimet e “menaxhimit të mirë”. Shembujt e praktikave më të mira mund të jenë të lidhura me aktivitetet e komunës në infrastrukturë, menaxhimin e mbeturinave, ujit, parqeve, ujërave të zeza, ndriçimit publik, intervenimeve emergjente, shërbimet e ndryshme në arsim e shëndetësi dhe aktivitete tjera të kësaj fushe.

### **II. Lehtësimi i procedurave administrative**

Çështjet e procedurave administrative që ofron komuna për nevojat e qytetarëve janë të një rëndësie tjetër në shumë segmente të jetës dhe veprimtarisë së qytetarit. Mundësitë e komunës që qytetarët e saj të pajisen me dokumentacione të ndryshme në mënyra sa më të lehta dhe efikase janë të mëdha dhe të shumanshme. Shembujt e praktikave të mira në këtë sferë hyjnë aktivitetet komunale të cilat i lehtësojnë procedurat për pajisen e qytetarit me dokumentacion nga ai personal deri tek ai për veprimtari biznesore apo të çështjeve pronësore, urbanistike e katastrale.

## III. Rritja e të hyrave komunale

Projektet, investimet e aktivitetet komunale varen nga buxheti, i cili, një pjesë vjen në komunë si pjesë e grantit nga buxheti shtetëror, dhe pjesa tjetër si pjesë e të hyrave vetanake të komunave. Shembuj të praktikave të mira në këtë drejtim mund të jetë angazhimi konkret i komunës në rritjen e të hyrave të ndryshme komunale në mënyrë që këto të hyra të rikthehen tek qytetari dhe ambienti ku jeton në formë të investimeve dhe projekteve infrastrukturore.

## KRITERET E PËRZGJEDHJES SË PRAKTIKËS MË TË MIRË

Në mënyrë që të marrin statusin e praktikës më të mirë, shembujt e paraqitur duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

**Suksesi** - Praktika është zbatuar dhe tregon rezultate të mira. Qytetarët janë familjarizuar me këtë dhe reagimi i tyre është pozitiv.

**Transparenca dhe pjesëmarrja** - Hapat në Praktikë kanë qenë të përcaktuar mirë dhe të paraqitura në mënyrë që është e kuptueshme për publikun e gjerë. Qytetarët kanë pasur mundësinë që të marrin pjesë në procesin e hartimit të praktikës më të mirë, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të praktikës.

**Rëndësia** - Objektivat e Praktikës korrespondojnë me probleme që lidhen me një mjedis të veçantë dhe ato janë identifikuar në planin strategjik të komunës ose disa dokumente të tjera zyrtare dhe vetë praktika kontribuon në zgjidhjen e problemeve kryesore në komunë.

**Zbatimi** - Praktika mund të transferohet/zbatohet në komuna tjera.

**Qëndrueshmëria** - Ka të dhëna të mjaftueshme në dispozicion në lidhje me vazhdimësinë e zbatimit të Praktikës ose vazhdimin e ndikimit të Praktikës në të ardhmen. Efektet afatgjate të praktikës janë siguruar me anë të mekanizmave të qartë (dokumenteve zyrtare, ndryshimi në sjelljen e qytetarëve ...). Qëndrueshmëria financiare është siguruar (ka burime të qarta dhe të caktuara të financimit të praktikës).

## SI DO TË PËRZGJIDHEN PRAKTIKAT MË TË MIRAT?

Asociacioni i Komunave të Kosovës do të bëjë një listë të shembujve të praktikave më të mira të paraqitura nga komunat. Pas kësaj, Paneli Përzgjedhës do të bëjë një vlerësim të kërkesave të pranuar dhe listën e ngushtë të komunave kandidatë. Lista e ngushtë do të ketë deri në 15 shembuj të praktikës më të mirë.

Anëtarët e Panelit Përzgjedhës (2-3) dhe Menaxheri i Projektit do të vizitojnë komunat në listën e ngushtë. Gjatë këtyre vizitave, komunat do të kërkohen të demonstrojnë

# Programi i praktikave të mira

tek Paneli Përzgjedhës praktikën e tyre më të mirë në fushën përkatëse tematike, duke ju treguar Panelit Përzgjedhës shembujt e praktikës së tyre më të mirë.

Pas vizitave në komuna, Paneli Përzgjedhës do të zgjedhë deri në 9 praktika (deri në 3 në çdo fushë tematike). Përfaqësuesit e komunave të zgjedhur do të bëjnë prezantimin zyrtar të praktikave të tyre në takimin e përbashkët në mes të Panelit Përzgjedhës dhe Grupit Drejtues. Në takim, Paneli Përzgjedhës do të marrë vendimin përfundimtar mbi praktikën më të mira për çdo fushë tematike.

## CEREMONIA E SHPËRBLIMIT

Shembujt e përzgjedhur të praktikave më të mira do të shpallet në Ceremoninë e Ndarjes së Shpërblimeve. Ceremonia do të organizohet nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Në ceremoni do të marrin pjesë përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës, Këshillit të Evropës, përfaqësuesit e të gjitha komunave të Kosovës si dhe organizata tjera/institucione që kanë marrë pjesë në program si dhe anëtarët e Grupit Drejtues. Kryetari i AKK-së së bashku me Ministrin e MAPL-së do të shpallë zyrtarisht fituesit gjatë ceremonisë. Ceremonia do të mbahet në tetor 2013.

## SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT NË LIDHJE ME PRAKTIKËN E MIRË

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe komunat fituese do të nënshkruajnë marrëveshjen për shpërndarjen e praktikave më të mira të tyre.

Mënyra e shpërndarjes së informacionit mbi praktikat më të mira, pjesërisht do të varet nga nevojat e komunave tjera (trajnime, konsultime, etj), por do të varet nga kapaciteti i komunave fituese të praktikave më të mira (seminare, punëtori, ditët e dyerve të hapura, publikime dhe përdorimin e internetit, përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve promovuese, gazeta, ekspozita, etj).

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Këshilli i Evropës do të ofrojë asistencë në përhapjen e praktikave më të mira.

"Udhëzuesi për Shpërndarjen e Praktikave më të mira", do të përgatitet në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në mënyrë që të lehtësojë përhapjen dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.

## AKTIVITETET DHE AFATET E PROGRAMIT

Programi “Përzgjedhja e Praktikës më të mirë në Komunitet e Kosovës” do të implementohen përmes aktiviteteve dhe afateve si më poshtë:

AKTIVITETI	AFATI KOHOR
Konferencë për Praktikën e Mirë	Tetor 2012
Dorëzimi i aplikacioneve nga Komunitet e Kosovës	Nëntor 2012 / Janar 2013
Përzgjedhja fillestare dhe përgatitja e listës së ngushtë për përzgjedhjen e praktikave më të mira – takimet e Panelit Përzgjedhës	Shkurt - Mars
Organizimi i vizitave verifikuese në komunitet e përzgjedhura për demonstrimin e praktikës së tyre të mirë dhe vlerësimin fillestar	Prill - Maj
Vlerësimi i praktikave sipas fushës nga Paneli Përzgjedhës	Qershor
Prezantimi i listës së ngushtë të praktikave të mira përpara Komitetit Drejtues/Organizimi i takimit për të dëgjuar prezantimet individuale të komunitet rreth praktikave më të mira dhe të bien dakord rreth ndarjes së praktikës më të mirë	Gusht Korrik
Përzgjedhja e praktikave të mira nga Komiteti Drejtues	Shtator
Ceremonia e Ndarjes së Çmimeve	Tetor
Përgatitja e Udhëzuesit të Praktikave të Mira për shpërndarje	Nëntor 2013
Ndjekja dhe monitorimi i shpërndarjes	Nëntor 2013 / Mars 2014

## SI TË APLIKONI?

Të gjitha komunitet janë të ftuar të aplikojnë për statusin e praktikës më të mirë, për ato tema që ata besojnë se janë duke performuar praktikën më të mirë bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë broshurë. Të gjitha komunitet që janë të interesuar të marrin pjesë në konkurs duhet të plotësojnë formularin e aplikimit që është një shtojcë në këtë Broshurë, e cila mund të gjendet edhe në faqen e internetit të Asociacionit të Komunitet të Kosovës [www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net). Poashtu Formulari i Aplikimit do t'u dërgohet nga AKK-ja të gjitha komunitet. Formulari i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e Asociacionit të Komunitet të Kosovës (Rr.Gustav Mayer Nr. 5 – 10000 - Prishtinë) ose përmes e-mail në ([info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net) dhe [arsimosmani@komunat-ks.net](mailto:arsimosmani@komunat-ks.net)) jo më vonë se 31 janar 2013. Numri i aplikimit për një komunitet, as në numër e as në fushë nuk është i kufizuar. Formulari i aplikimit duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i komunitet (kryetari i komunitet ose nënkryetari i komunitet). Dokumentet, materialet, fotografitë që përdoren për të mbështetur rezultatin e praktikës më të mirë do të dorëzohen në të njëjtën mënyrë sikur formulari i aplikimit. Për të gjitha pyetjet shtesë që lidhen me plotësimin e Formularit të Aplikimit, ju mund të kontaktoni Asociacionin e Komunitet të Kosovës dhe Konsulentin Lokal, z. Arsim Osmani, në telefon dhe e-mail kontakt të cekura më poshtë.

# Programi i praktikave të mira

## FORMULARI I APLIKIMIT PËR SHEMBUJ TË PRAKTIKËS MË TË MIRË TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

Emri i komunës:

Informacion të shkurtër rreth Komunës (deri në 100 fjalë):

Tema për aplikimin e shembullit të praktikës së mirë (shkruani X në katrorin afër temës për të cilën kërkesa është dorëzuar):

- Përmirësimi i Shërbimeve Publike Komunale
- Lehtësimi i procedurave administrative
- Rritja e të hyrave komunale

Emri i shembullit të praktikës së mirë:

Përmbledhje e shembullit të praktikës së mirë.

Personi në komunë i ngarkuar me zbatimin/koordinimin e projektit të nominuar:

Pozita në komunë:	-
Kontakt adresa:	-
Telefoni:	-
E-mail:	-

Kryetari i Komunës

Emri dhe Mbiemri

Vula

Nënshkrimi



## INFORMACION NË LIDHJE ME SHEMBULLIN E PRAKTIKËS MË TË MIRË

### 1. Problemet kryesore në komunë

Përshkruani problemet kryesore në komunë lidhur me shërbimet/shërbime komunale/çështjet e kryera nga komuna; citoni dokumente zyrtare, ku janë identifikuar problemet e cekura.

### 2. Përshkrimi i problemit, i cili kishte për qëllim që të zgjidhet nga shembulli i praktikës së mirë

Përshkruani kontekstin, shkaku/shkaqe, kohën e shfaqjes së problemit, cili ishte grupi synues dhe në cilën mënyrë janë të prekur nga ekzistenca e problemit.

### 3. Objektivat e praktikave më të mira

Çfarë keni dashur të arrini me shembullin e praktikës së mirë.

### 4. Inicimi dhe përgatitja e praktikave të mira

Kush e ka iniciuar zgjidhjen e problemit (komuna, qytetarët, donatorët, organizatat jo-qeveritare, kompanitë publike, ...)? Kush i ka zhvilluar hapat për zbatimin e praktikave të mira dhe në çfarë mënyre (me anë të strategjisë, planit të veprimit, projekt propozimit, ...)? A është bazuar praktika e mirë në planin strategjik të përgjithshëm ose të veçantë të komunës? Pse keni vendosur për këtë iniciativë?

### 5. Realizimi i praktikës së mirë

Përshkruani shkurtimisht praktikën e mirë. Cilat aktivitete janë realizuar gjatë zbatimit të praktikës së mirë (përgjigju pyetjeve kyçe relevante për përshkrimin e veprimtarisë: Çfarë nënkuptonte aktiviteti? Kush e ka menaxhuar/realizuar veprimtarinë? Sa kohë ka zgjatur aktiviteti? Ku është realizuar aktiviteti? ?) A ka komuna juaj një partner në zbatimin e praktikës (organ shtetëror, organizatë jo-qeveritare, donatore ndërkombëtare ...), nëse po shkruani titullin e saj të saktë dhe llojin e asistencës së dhënë (financiare, eksperte, teknike ...).

# Programi i praktikave të mira

---

Kush e ka menaxhuar procesin e zbatimit të praktikave të mirë (komuna ose partneri)? Kur keni filluar me zbatimin e praktikës së mirë dhe për sa kohë ka zgjatur zbatimi i tij? A ishte zbatuar plotësisht praktika? Nëse jo, sa kohë do të duhet në mënyrë që të përfundoj zbatimi i saj? A ka pasur probleme të papritura gjatë zbatimit të praktikës së mirë dhe si i keni kapërcyer ato?

Çfarë metode keni përdorur për informim publik dhe përfshirjen e qytetarëve në procesin e përgatitjes dhe realizimit të praktikës së mirë (takim, debat të hapur publik, mediet, fletëpalosje/broshura, uebfaqja e komunës, e-mail ...)

## 6. Rezultatet e praktikës së mirë

Shpjegoni se si ka ndikuar praktika juaj e mirë në zgjidhjen e problemit të përshkruar në pikën dy të kësaj forme? A ka ndikuar praktika e mirë në organizimin e administratës dhe si? Cili ishte ndikimi i praktikës së mirë për përdoruesit e shërbimeve dhe cilët përdorues janë prekur më së shumti? Cila ishte përqindja e popullsisë që kanë përfituar më shumë nga praktika e mirë, sipas vlerësimit tuaj?

A ka një rekord zyrtar të rezultateve të praktikave të mira (kush i mban shënimet dhe në cilën mënyrë)?

Shpjegoni se si ka ndikuar praktika e mirë në zgjidhjen e problemeve kryesore të komunës, siç përshkruhet në pikën 1 të këtij formulari?

## 7. Resurset

Cilat janë shpenzimet e realizimit të praktikës së mirë? Cilat burime financiare i keni përdorur (buxhetin komunal, buxhetin e republikës, donatorët, kredi, ..)? Cilat ishin

# Programi i praktikave të mira

---

burimet e nevojshme për zbatimin e praktikës së mirë (burimet njerëzore brenda dhe jashtë komunës, zyrat, pajisjet e tjera)? A ka shkaktuar praktika e mira kursime në buxhetin komunal, në qoftë se po tregoni sa dhe si?

A e keni promovuar praktikën e mirë dhe në cilën mënyrë (në medime, në konferencë, takime dhe të ngjashme)? A janë qytetarët e komunës suaj të familjarizuar me praktikën tuaj të mirë dhe deri në çfarë mase janë të kënaqur? A janë komunat tjera të familjarizuara me praktikën tuaj të mirë? A ka aplikuar ndonjë komunë tjetër shembullin tuaj të praktikës së mirë?

## 8. Qëndrueshmëria e praktikës së mirë

A do të vazhdoj zbatimi i praktikës së mirë, nëse po cili do të jetë burimi i financimit? Në cilën mënyrë praktika e mirë do të ketë efekte në të ardhmen? A ka mekanizma të qartë që janë duke ofruar për vazhdimin e ndikimit të praktikës së mirë në të ardhmen (dokumente zyrtare, sjelljet e ndryshuara të qytetarëve ...)?

## 9. Mbështetja për komunat tjera të cilat dëshirojnë të marrin përsipër praktikën e mirë

A ka parakushte specifike (organizimi, financimi, zona gjeografike, ...) që komunat tjera do të duhet të përmbushin në mënyrë që të aplikojnë praktikën tuaj të mirë? Çfarë mund të ofroni për komunat tjera të cilat do të donin të zbatonin shembullin tuaj (vizita, trajnime, materiale, asistencë ekspertësh, këshillime ...)?

## 10. Mësimet e nxjerra - rekomandimet

Tregoni rekomandimet tuaja mbi atë që mund të bëhet më mirë për zbatimin e përsëritur të praktikës së mirë, cilat ishin pengesat tuaja kryesore që ju keni hasur dhe çfarë ishin mësimet e nxjerra nga zbatimi i shembullit?

Rr. "Gustav Mayer"  
Nr.5  
Prishtinë

Tel. 038 245 734

Fax. 038 245 732

[info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

AKM has the status of an observer in Council of Europes Congress of Local and Regional Authorities in Europe. It is a permanent member of NALAS (Network of Associations of Local Authorities in South-East Europe), member of LOGON network, member of LOGIN network. Member is an Invited Association (similar to the status of an observer) in Committee of Europe for Municipalities and Regions (CEMR) and member in ALDA (Association of Local Democracy Agencies).

